



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 117, Datë 24.04.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TEK SHOQËRIA “HEC POLEMI” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 16, 20, 37, pika 2, gërma “a” dhe 44 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 17, pikat 2, 3 dhe 5, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 4, gërma “b”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/2 prot., datë 23.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. është mbajtëse e licencës Nr. 577, Seria P24, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.04.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005 prot., datë 30.03.2026, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën për transferimin e plotë të licencës së sipërcituar, tek shoqëria e krijuar “HEC Polemi” sh.p.k., me ortak të vetëm shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe operojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/1 prot., datë 07.04.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për transferim sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin/informacionin e kërkuar për transferimin e licencës sipas gërmave (b dhe c).
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 17 “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës”

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë të dhënat e kërkuara në zbatim të gërmave b dhe c të Shtojcës 1 të Rregullores.
 - **gërma “d”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës për vlefshmërinë e marrëveshjes së transferimit, të përcaktuar në këtë marrëveshje.
 - **gërma “f”:** Shoqëria duhet të depozitojë miratimin apo qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me këtë transferim.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 1 dhe 5 të Rregullores së licencimit, ku përcaktohet se: *aplikimi për transferimin e asetëve fikse duhet të bëhet paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit, dhe duke qenë se, sa informuar nga shoqëria, transferimi i licencës do të shoqërohet dhe me transferimin e plotë të asetëve të hidrocentralit, vlerësohet fillimi i procedurës dhe për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës në zbatim të Rregullores së transferimit të asetëve.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës Nr. 577, Seria P24, dhënë shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.04.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
2. Të fillojë procedurën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI